



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 64

Datë: 02. 10. 2021. Ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Goerdana LRifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.
- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve për Këshillat e Vendvotimeve (kryesuesit, anëtarët dhe anëtarët rezervë) për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021.

5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Sekretariati, lidhur me aktivitetet e prokurimit.

6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik.

7. Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Përshëndetje për të gjithë, e hapim mbledhjen e 64 të KQZ-së. Atëherë, para vetes e keni rendin e ditës. E hedh në votim rendin e dtës, kush është për këtë rend...?

Unanimisht votohet rendi i ditës.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtare të KQZ-së, me datën 2 tetor keni pranuar raportin lidhur me aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së në vazhden e përgatitjes dhe organizimit të zgjedhjeve që do të mbahen me 17 tetor. Më lejoni të ju njoftoj se nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datën 1 tetor ka ardhur një shkresë drejtuar KQZ-së nga znj. Nagavci, ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndalimin e aktiviteteve të fushatës në hapësirat e brendshme të shkollave, pra ku ndër të tjera, kërkon nga KQZ që subjekteve politike të ju ndalohet shfrytëzimi i hapësirave të brendshme të shkollave për aktivitete të fushatës me qëllim që hapësirat e shkollës të mbesin të sigurt dhe në shfrytëzim vetëm për procesin mësimor e cila, do të ndihmonte në ruajtjen e shëndetit të fëmijëve dhe qëndrim të sigurt. Pra, kjo është kërkesa që iu është drejtuar KQZ-së. Në kuadër të përgatitjeve tjera, Sekretariati aktualisht e ka në periudhën e votimit jashtë Kosovës, pra është periudha e votimit përmes postës e cila ka filluar me 15 shtator, dhe do të përfundojë me 15 tetor. Deri më datën 1 tetor, KQZ ka pranuar gjithsej 1932 pako me fletëvotime të cilat janë tërhequr nën përcjelljen e policisë së Kosovës nga zyrat postare, pra kemi postën nr.6 në Prishtinë ku KQZ në kutinë postare e ka qasjen e vet dhe nga postat e shpejta, siç janë posta “DHL” dhe “Henty”. Pra, të gjitha këto pako, janë të ruajtura në hapësirën e cila shfrytëzohet nga KQZ në hapësirën në Ministrinë e Infrastrukturës, zyra që KQZ e shfrytëzon për procesin zgjedhor pra është fjala për objektin e Infrastrukturës në ndërtesën e

Gërmisë. Pakot me fletëvotime, janë duke u ruajtur nga Policia e Kosovës përgjatë 24 orëve dhe hapësirat e brendshme janë të mbuluara dhe izoluara nga kamerat vëzhguese.

Sa i përket regjistrimit të votuesve me nevoja të veçanta, KQZ bazuar në planin operacional i ka dërguar shkresa në dy institucione: është fjala për Ministrinë e Drejtësisë ku i ka dërguar shkresë për të kërkuar të dhënat e votuesve që në ditën e zgjedhjeve gjenden në qendrat e paraburgimit, qendrat korrektuese dhe në burgun e sigurisë së lartë, dhe shkresa tjetër është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë për të kërkuar të dhënat e votuesve që në ditën e zgjedhjeve gjenden në institucione të kujdesit shëndetësor. Afati për t'i pranuar të dhënat me emrat e votuesve në këto dy institucione, është më 4 tetor.

Më lejoni të ju njoftoj se shtypja e listave përfundimtare të votuesve dhe fletëvotimeve janë dy procese që janë në proces e sipër: më 4 tetor do të filloj shtypja e listave përfundimtare dhe listave komunale të votuesve dhe ky proces do të zgjas përafërsisht 7 ditë, ndërsa procesi i shtypjes së fletëvotimeve për kryetar komune , kuvendin komunal dhe broshurave të kandidatëve është përfunduar dhe pritet që gjatë kësaj jave të bëhet edhe nisja e fletëvotimeve për në Kosovë. Sa i përket fushatës zgjedhore për periudhën 15 ditore të fushatës zgjedhore, nga data 16 shtator deri më 30 shtator, sipas raporteve nga terreni që i kemi përmes KKZ-ve dhe nga policia, janë paraqitur 390 kërkesa për tubime politike duke respektuar rregullat zgjedhore dhe vendimin e qeverisë për masat mbrojtëse anticovid. Sipas raportimeve nga terreni që i kemi, deri më datën 30 shtator, 9 tubime janë mbajtur pa i përfillur këto masa dhe rregullat zgjedhore, si dhe vendimin e qeverisë së RKS për masat mbrojtëse anticovid, kurse prej 390 kërkesave për tubime politike të cilat i kanë miratuar dhe lejuar Komisioni Komunal i Zgjedhjeve dhe Policia e Kosovës, 76 prej tyre edhe pse janë lajmëruar për tu mbajtur, nuk janë mbajtur prej subjekteve politike. Gjatë kësaj periudhe 15 ditore, që nga fillimi i fushatës zgjedhore deri më tani në kohën kur po raportojmë, para KQZ-së sipas raporteve nga KKZ-të dhe Policia, fushata konsiderohet dhe vazhdon të jetë e qetë...

Arianit Elshani: Faleminderit shumë për raportimin, është edhe voluminoz edhe përmbajtësor, ka disa dhëna të cilat janë të rëndësishme edhe për subjektet politike, por edhe për opinionin publik lidhur edhe me periudhën e votimit jashtë Kosovës dhe aktivitetet e tjera. E pash dhe e dëgjova këtë raportim me vëmendje, po e lexova edhe përmbajtjen e kërkesës nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit për ndalimin e aktiviteteve politike pra tubimeve me qytetarë në hapësirat e brendshme të shkollave. Mendoj që është mirë që të sqarohet për subjektet politike nëse bëhet fjalë për hapësirat e brendshme apo për hapësirat në tërësi, pra të dihet që subjektet politike kanë të drejtë që të zhvillojnë aktivitetet, tubimet e tyre në oborret e shkollave. Kjo, besoj që është e rëndësishme por, nuk po e shoh që është e shkruar decidivisht dhe mendoj se duhet të sqarohet për të gjitha subjektet politike. E pash në

kërkesë që të nxirret një akt juridik! Ne, veç e kemi një rregull lidhur me tubimet politike ku edhe ligji parandalon tubimet në hapësira publike pa marrë leje, e veçmas këto të shfrytëzimit të institucioneve apo të hapësirave të institucioneve dhe dihet se, u lejohet subjekteve politike që ti zhvillojnë këto aktivitete vetëm nëse ne kemi marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Në këtë rast, ne e shohim që ky memorandum përfundon për shkak të pandemisë dhe nevojës që çdo nxënës të jetë i sigurt në këto hapësira, pra ju lutem krye shef që të sqaroni për çka bëhet fjalë konkretisht për hapësirat e brendshme apo edhe për oborret e shkollave. Tjetra: lidhur me periudhën e votimit jashtë Kosovës, pasqë se janë pranuar 1932 pako me fletëvotime. Kam një pyetje: kur janë pranuar nga këto kompanitë, edhe private postare dhe nga posta e Kosovës...?

Florian Dushi: Edhe unë kam pikërisht çështjen e letrës nga Ministria e Arsimit! Unë konsideroj se kjo është kompetencë plotësisht e kësaj ministrie dhe drejtorive përkatëse komunale. Shkollat, në njëfarë forme janë në pronësi të tyre dhe menaxhohen nga ata, dhe janë përgjegjësit kryesorë të cilët mund të vendosin ti ndalojnë aktivitetet politike parazgjedhore në objektet e shkollave, prandaj vlerësoj se KQZ nuk ka nevojë të marrë asnjë vendim të kësaj natyre. Nga ajo që ka thënë Ministria e Arsimit, e që ndërlidhet me kushtet e pandemisë në të cilën gjendemi, konsideroj që fjala është për hapësirat e brendshme të shkollës.

Qëllimi është që nga lëvizjet e këtyre njerëzve, thjeshtë të mos rrezikohet shëndeti i fëmijëve tanë prandaj, unë e konsideroj si një të drejtë dhe të bazuar këtë vendim të cilin e ka marrë. Subjektet politike, mund ti shfrytëzojnë hapësirat e jashtme në numër të kufizuar, ashtu si është paraparë me masat e organeve kompetente për tu tubuar, dhe si KQZ konsideroj që nuk kemi nevojë për asnjë lloj vendimmarrje sa i përket kësaj çështje përveç që të ju bëjmë thirrje subjekteve politike që të respektojnë këtë vendim të Ministrisë së Arsimit, dhe t'i bëjmë thirrje Ministrisë së Arsimit që përmes drejtorëve të shkollave të kujdeset për implementimin e këtij vendimi...

Alim Rama: Kisha një pyetje lidhur me votimin jashtë Kosovës, ku janë pranuar 2000 pako.....(nuk dëgjohej)...

Čemailj Kurtişi: Nuk dëgjohej incizimi...

Burim Ahmetaj: Sa i përket kërkesës nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Rregulla Zgjedhore nr. 13 /2013, pra rregulla për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve dhe njoftime për ngjarje publike, neni 4 e përcakton qartë se tubimet politike nuk mund të mbahen në shkolla, sidomos në hapësira të brendshme gjatë orarit të mësimi, veç në raste kur KQZ ka memorandum të marrëveshjes me

qeverinë e Kosovës për shfrytëzimin e hapësirave publike, mirëpo në këto raste KQZ sipas praktikave nuk nxjerr ndonjë udhëzim apo vendim për shfrytëzimin e këtyre hapësirave...

Sa i përket vëzhguesve, lidhur me informimin e vëzhguesve, i kemi informuar të gjithë vëzhguesit lidhur me këtë proces të votimit jashtë Kosovës dhe dërgesat janë në proces e sipër. Sigurisht, kemi kontaktuar edhe me qendrën tranzitore të postës së Kosovës dhe deri më tani, nuk kemi kërkesa shumë të mëdha mirëpo, në mënyrë progresive jemi duke u marre me të gjitha dërgesat që dërgohen me fahun postal në QTP, DHL dhe në postat tjera...

Arianit Elshani: KQZ ka pas memorandume me Ministrinë e Arsimit ,Shkencës edhe Teknologjisë unë vetëm po kërkoj që të sqarohet pra që të mos jetë një interpretim kështu si mund ti kemi disa interpretime brenda KQZ-së mos të ketë interpretime të ndryshme në komuna të ndryshme këtë po kërkoj që të kemi një interpretim të saktë nga ajo që është kërkuar nga Ministria në qoftë se ndalohen në tërësi ndalohen në tërësi , në qoftë se u lejohet në hapësirat e oborreve të shkollave në rregull jemi vetëm të sqarohet për subjektet politike për kandidatët e pavarur, të gjithë secili që është në garë që të dijë qartë ku ka të drejtë ti organizojë këto tubime , na takon neve meqenëse kemi pas komunikim është kërkuar nga ne që të sqarohet ndoshta mund ti kërkonti një imella në qoftë se nuk e kemi sot unë po e shoh hapësira të brendshme mirëpo të jetë një interpretim uniform prej të gjitha komunave

Burim Ahmetaj: Nuk dëgjohet incizimi...

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka tjetër ? Jo, atëherë vazhdojmë me aktivitetin tjetër aktivitetet e zyrës së partive...

3.Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve:

Yll Buleshkaj: I nderuar kryetar, të nderuar anëtarë: ashtu siç e keni në agjendë, para jush keni rekomandimin për akreditim të vëzhguesve. Pra, për sot rekomandojmë të akreditohen 2951 vëzhgues të cilët, i shtohen numrin prej: 11.438 të cilët janë akredituar më herët. Në tërësi, pas kësaj do ti kemi 14.389 vëzhgues.

Kreshnik Radoniqi: Po fillojmë me radhë...

Yll Buleshkaj: Fillimisht, konstatoj se të gjitha entitetet që janë rekomanduar për tu akredituar nuk kanë probleme asfare, qoftë ligjore ose të ngjashme! Së pari, rekomandojmë akreditimin e iniciativës qytetare “Ne mundemi” me 7 vëzhgues.

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime, akreditohet iniciativa qytetare “ Ne mundemi’ me 7 vëzhgues afat shkurtë.

Yll Buleshkaj: OJQ vendore “Toleranca” aplikon me 13 vëzhgues të cilët rekomandojmë të akreditohen.

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet 13 vëzhgues afat shkurtë.

Yll Buleshkaj: Media vendore Telegrafi aplikon me 13 vëzhgues. Rekomandohen për tu akredituar.

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime, akreditohet media vendore Telegrafi me 13 vëzhgues afat shkurtë.

Yll Buleshkaj: Media tjetër vendore Kosova Sot Online, aplikon për akreditimin e 5 vëzhgues. Rekomandojmë të akreditohen...

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet media vendore Kosova Sot Online me 5 vëzhgues afat shkurtë.

Yll Buleshkaj: Media vendore Lajmi.net po ashtu aplikon për akreditimin e 8 vëzhguesve të cilët i kanë kryer obligimet e tyre.

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet media vendore Lajmi.net me 8 vëzhgues afat shkurtë

Kreshnik Radoniqi: Partia politike e certifikuar Kosova Adalet Turk Partisi aplikon për akreditim të 52 vëzhguesve të tyre të cilët rekomandojmë për akreditim

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politika Kosova Adalet Turk Partisi me 52 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike e certifikuar Jenilik Turk Haraket Partisi aplikon për akreditimin e 31 vëzhguesve

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Jenilik Turk Haraket Partisi me 31 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike Nasha Iniciativa aplikon për akreditimin e 24 vëzhguesve

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Nasha Iniciativa me 24 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike organizata Balli Kombëtar Demokrat aplikon për akreditimin e 26 vëzhguesve të tyre për ditën e zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike organizata Balli Kombëtar me 26 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike Social Demokratska Unia ka aplikuar për akreditimin e 97 vëzhguesve

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Social demokratska Unia me 97 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës PDAK ka aplikuar për akreditimin e 10 vëzhguesve , i kanë përmbushur kushtet dhe kriteret ligjore

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës me 10 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike Pokretza Gora po ashtu ka aplikuar për akreditimin e vëzhguesve 5 , i kanë përmbushur kriteret që i parasheh ligji dhe rregullorja

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Pokretza Gora me 5 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës ka aplikuar për akreditimin e 3 vëzhguesve të tyre

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës me 3 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike Lëvizja për Bashkim ka aplikuar për akreditimin e 36 vëzhguesve të cilët rekomandohen për akreditim

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Lëvizja për Bashkim me 36 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike Partia e Ashkalinjëve për Integrim PAI aplikon për akreditimin e 50 vëzhguesve të cilët rekomandohen për tu akredituar

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Partia e Ashkalinjëve për Integrim akreditohet me 50 vëzhgues afat shkurtë

Yll Buleshkaj: Partia politike Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës ka aplikuar për akreditimin e 143 vëzhguesve të cilët i kanë plotësuar kushtet dhe rekomandohet për tu akredituar

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës me 143 vëzhgues

Yll Buleshkaj: Partia politike Partia Socialdemokrate PSD aplikon për akreditimin e 113 vëzhguesve të tyre të cilët i rekomandojmë KQZ-së për ti aprovuar

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime akreditohet partia politike Partia Socialdemokrate me 113 vëzhgues afat shkurtë

Ylli Buleshkaj : Subjekti politik Koalicija VAKAT ka aplikuar për akreditimin e 387 vëzhguesve të cilët i rekomandojmë për tu aprovuar

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime miratohet....

Yll Buleshkaj: Iniciativa qytetare për Kllokot aplikon për akreditimin e 4 vëzhguesve të cilët i rekomandoj për ti votuar

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime miratohet....

Yll Buleshkaj: Iniciativa Qytetare Grajancka Inciativa Bosnjaka Istog ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 10 vëzhguesve të cilët i rekomandojmë për ti aprovuar

Kreshnik Radoniqi: Me vota unanime miratohet....

Kreshnik Radoniqi Iniciativa qytetare Narodno Jedinspo aplikon për akreditimin e 14 vëzhguesve të cilët i kanë plotësuar kriteret dhe rekomandohen me u aprovu

Akreditohet sipas rekomandimit

Kreshnik Radoniqi: Iniciativa qytetare Forca e Diasporës ka aplikuar për akreditimin e 37 vëzhguesve të cilët ju rekomandojmë për tu aprovuar

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: Iniciativa qytetare Bashkë për Istogun ka aplikuar për akreditimin e 20 vëzhguesve të cilët i kanë plotësuar të gjitha kriteret ligjore dhe rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit ..

Kreshnik Radoniqi: Iniciativa qytetare Lista e Ashkalinjëve ka aplikuar për akreditimin e 125 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim nga KQZ

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: Iniciativa qytetare Green për Drenas ka aplikuar për akreditimin e 34 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: Kandidati i pavarur i certifikuar Iliaz Bajraktar ka aplikuar për akreditimin e 15 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: Kandidati i pavarur Jugoslav Jovanovic ka aplikuar për akreditimin e 2 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: Kandidati i pavarur Agim Xheli aplikon për akreditimin e 34 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: Kandidati i pavarur Lulzim Bexheti aplikon për akreditimin e 5 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim nga KQZ

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: Kandidati i pavarur Rufki Suma ka aplikuar për akreditimin e 22 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim nga KQZ

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ vendore Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar ka aplikuar për akreditimin e 20 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ tjetër Qendra për Politika dhe Avokim ka aplikuar për akreditimin e 37 vëzhguesve të cilët i kanë plotësuar të gjitha kushtet dhe rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ vendore Rise and Shine ka aplikuar për akreditimin e 43 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim.

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ vendore shoqata Lets Learn ka aplikuar për akreditimin e 50 vëzhguesve të tyre të cilët i kanë plotësuar kushtet dhe rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ tjetër Lidhja Rinore Blue ka aplikuar për akreditimin e 30 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ vendore Center Majednici Zajednice ka aplikuar për akreditimin e 21 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ vendore Qendra Kulturore Atdheu ka aplikuar për akreditimin e 47 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ tjetër “Center for Social Information...”, ka aplikuar për akreditimin e 22 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ vendore, ka aplikuar për akreditimin e 24 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim.

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ tjetër Qendra për Edukim, Inovacion dhe zhvillim profesional Akademia ka aplikuar për akreditimin e 52 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: OJQ tjetër Days to our future ka aplikuar për akreditimin e 57 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit...

Kreshnik Radoniqi: Organizata ndërkombëtare Political Contability Foundation ka aplikuar për akreditimin e 15 vëzhguesve afatshkurtër dhe ne i rekomandojmë akreditimin e tyre

Akreditohet sipas rekomandimit..

Kreshnik Radoniqi: Iniciativa qytetare e certifikuar lista e pavarur Bekim Jashari ka aplikuar për akreditimin e 139 vëzhguesve të cilët rekomandohen për tu aprovuar

Akreditohet sipas rekomandimit..

Kreshnik Radoniqi: OJQ “Center for Social Inclusion Graçanica” ka aplikuar për akreditimin e 33 vëzhguesve të cilët rekomandojmë...

Akreditohet sipas rekomandimit..

Kreshnik Radoniqi: Partia politike e certifikuar Partia e Drejtësisë ka aplikuar për akreditimin e 18 vëzhguesve shtesë prej tyre se një grup e kemi akredituar më përpara

Akreditohehen..

Kreshnik Radoniqi: Organizata ndërkombëtare, komisioni i vëzhguesve Unioni Evropian aplikon për akreditim e 14 vëzhguesve shtesë ,kanë plotësuar të gjitha kriteret

Akreditohehen

Kreshnik Radoniqi: Partia politike Srpska Lista ka aplikuar për akreditimin e 34 vëzhguesve të cilët i kanë plotësuar kushtet dhe rekomandohen ...

Akreditohehen

Kreshnik Radoniqi: OJQ vendore Roma Veritas Kosovo ka aplikuar për akreditimin e 34 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim nga KQZ

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Partia politike Nova Demokratska Stranka ka aplikuar për akreditimin e 189 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Iniciativa qytetare për Obiliq ka aplikuar për akreditimin e 80 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Iniciativa qytetare Reformimi demokratik për Ferizaj ka aplikuar për akreditimin e 55 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen sipas rekomandimit

Kreshnik Radoniqi: Kandidati i pavarur Hajrush Stublla ka paraqitur kërkesën për akreditimin edhe të një vëzhguesi i cili rekomandohet për aprovim

Akreditohet sipas rekomandimit

Kreshnik Radoniqi: Media ndërkombëtare AL Jazeera Balkans ka aplikuar për akreditimin e 6 vëzhguesve të cilët i kanë plotësuar kushtet dhe rekomandohen për aprovim

Akreditothen sipas rekomandimit

Kreshnik Radoniqi: Media vendore Radio Kosova ka aplikuar për akreditimin e 17 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Media tjetër Radiotelevizija Herc ka aplikuar për akreditimin e 15 vëzhguesve të cilët i kanë plotësuar kushtet dhe rekomandohen për aprovim

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Media vendore VF city radio ka aplikuar për akreditimin e 15 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Media vendore Radio Herc ka paraqitur kërkesën e saj për akreditimin e 15 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Do të thotë i kemi dy Radio televizioni Herc edhe Radio Herc....

Kreshnik Radoniqi: Media vendore Albanian Post ka aplikuar për akreditimin e 15 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Media tjetër Radio Televizioni i Kosovës ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 28 vëzhguesve të tyre të cilët akreditothen për aprovim

Akreditothen sipas rekomandimit

Kreshnik Radoniqi: Media vendore Radio contact plus ka aplikuar për akreditimin e 6 vëzhguesve të tyre të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen sipas rekomandimit

Kreshnik Radoniqi: Media vendore portali demokracia.com ka aplikuar për akreditimin e 5 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim nga KQZ

Akreditothen sipas rekomandimit

Kreshnik Radoniqi: Media tjetër Agjensia e Lajmeve Kosova Press ka aplikuar për akreditimin e 22 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditothen sipas rekomandimit

Kreshnik Radoniqi: Media ndërkombëtare Association Press ka aplikuar për akreditimin e 5 vëzhguesve, rekomandohet aprovimi i tyre

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Partia politike e certifikuar Partia Demokratike e Kosovës ka shtese edhe 101 vëzhgues të cilët janë plotësuar ndërkohë dokumentacioni ka qenë në mungesë dhe rekomandohen për aprovim

Akreditothen

Kreshnik Radoniqi: Ngjashëm është rasti me partinë politike Partia Demokratike e Kosovës të cilët kanë plotësuar aplikacionet edhe për 157 vëzhgues të tjerë të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohen

Kreshnik Radoniqi: Iniciativa qytetare e certifikuar Demokratët për Drenasin ka aplikuar për akreditimin e 135 vëzhguesve të cilët kanë plotësuar dokumentacionin dhe rekomandohen.

Akreditohen

Kreshnik Radoniqi: Dhe e fundit është OJQ vendore: Center for Democratic Culture nga Mitrovica të cilët kanë aplikuar për akreditimin e 17 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

Akreditohen sipas rekomandimit

Ylli Buleshkaj: Me kaq përfundoi rekomandimi në qoftëse ka ndonjë pyetje ...ajo që vlen të ceket paraprakisht sot është afati i fundit për aplikim të mediave për akreditim dhe punojmë deri në ora 4 ..

Florian Dushi: Ne, jemi përgjegjësit kryesorë të këtij procesi që zhvillohen prandaj duhet të kemi qasje, jo duhet, por kemi qasje në tërë procesin që zhvillohet edhe aty, edhe në qendër të numërimit edhe çdo kund tjetër...Duke pas parasysh këtë numër të madh të vëzhguesve, ata e bëjnë më kredibil procesin zgjedhor! Megjithatë ndodh jo rrallë që vëzhguesit provojnë me ndikuar në procesin zgjedhor prandaj, i kanë edhe format dhe i dinë edhe detyrat shumica prandaj, po më intereson nëse zyra në ndonjë formë të komunikimit dhe të kontakteve me subjektet politike ua tërheq vërejtjen që vëzhguesit e tyre në ditën e zgjedhjeve t'i përmbushin pjesën e përgjegjësive dhe detyrave të tyre prej vëzhguesi dhe, në asnjë formë të mos provojnë me ndikuar ose me marrë rol në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit...

Ylli Buleshkaj: Zyra informon personat kontaktues të partive politike për të drejtat dhe obligimet e vëzhguesve që i kanë. Numri është i madh po në qoftë se e krahasojmë me zgjedhjet e tjera. Duket se do të jetë për 10 mijë më i vogël, nëse në zgjedhjet e kaluara paraprake kanë qenë deri në 35 mijë, tash nuk po shkon as 25 mijë...Kemi prodhuar edhe disa fletushka të cilat i përmbajnë detyrat dhe të drejtat e vëzhguesve, e kjo është menduar të prodhohen një për secilin vëzhgues. Në zgjedhjet e kaluara i kemi shpërndarë ose kemi tentuar ti shpërndajmë përmes partive politike apo entiteteve tjera që kanë aplikuar për akreditim, kësaj radhë Këshilli për Informim Publik ka rekomanduar që kjo të bëhet përmes qendrave të votimit...

Ilir Gashi: Mirë që janë gjithë këta vëzhgues sepse i shërbejnë procesit dhe mbikëqyrjes mbarëvajtjes së procesit zgjedhor! E kemi diskutuar në një mbledhje të mëhershme lidhur me atë se për shkak të pandemisë, pjesëmarrja e vëzhguesve duke përfshirë edhe subjektet politike por edhe të organizatave të ndryshme, mund të sjellë një numër të madh të personave të cilët do të gjinden nëpër shkolla, nëpër vendvotime dhe kjo pastaj, kjo i detyron edhe kryesuesit ta bëjnë njëfarë ndarje për faktin se ligjet janë të qarta sepse, jo më shumë se dy vëzhgues duhet të jenë të subjekteve politike në vendvotim. Do të ishte mirë që t'ua lëmë kryesuesve të vendvotimeve të vendosin për kapacitet e brendshme se sa vëzhgues duhet të jenë në vendvotim si për shkak kryesisht po them të pandemisë apo, të kemi ndonjë udhëzim uniform kështu që subjektet politike të paktën të kenë të gjitha nga një vëzhgues ashtu si e parasheh natyrisht edhe ligji...

Florian Dushi: Unë edhe më parë kam kërkuar nga Sekretariati do të thotë që duke njohur natyrën e zhvillimit të procesit zgjedhor kemi një plan të masave të cilat ne do ti marrim të cilat do të jenë praktikisht ndihmëse në këtë betejë të gjitha institucionet në vendin tonë kundër pandemisë prandaj, në këtë drejtim ne e kemi diskutuar çështjen...Konsideroj se për dy çështje neve duhet ose së paku për një prej tyre, na duhet vendimmarrje, ndërsa për tjetrën një udhëzim i qartë. E para, sa i përket vëzhguesve unë pajtohem që të kemi një vendim madje të kemi vendimin sipas së cilit subjekteve politike sepse ashtu si e tha kolegu ligji thotë jo më shumë se dy në rrethana të caktuara e vlerëson kryesuesi varësisht nga hapësira ose numri i përgjithshëm por unë konsideroj se si KQZ duke i njohur dhe duke i parë rrethanat pandemike të cilat jem ne duhet të marrim një vendim që subjektet politike të mos kenë më shumë se një vëzhgues brenda vendvotimeve dhe një çështje tjetër që unë mendoj që duhet me iu udhëzuar Komisionit Komunal të Zgjedhjeve dhe menaxherët e qendrave të votimit që ato radhë që krijohen pritjet që krijohen brenda objekteve të shkollës para secilit vendvotim thjeshtë të mos lejohen por nëse ka radhë të pritjes nëse ka numër të madh të votuesve në të njëjtën kohë nëpër qendra të votimit të njëjtat të barten jashtë që radhët të krijohen jashtë hapësirave të brendshme që e quajtmë të shkollave dhe të mos krijojmë tollovi brenda hapësirave të mbyllura në shkollë

Kreshnik Radoniqi: Të gjithë, jemi duke u pajtuar për këtë çështje, e ndoshta në mbledhjen e radhës përmes Sekretariatit duhet ta shikojmë edhe njëherë...Vazhdojmë me pikën e radhës...

4.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve për Këshillat e Vendvotimeve (kryesuesit, anëtarët dhe anëtarët rezervë) për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021:

Arianit Elshani: Këshilli për Operacione Zgjedhore ka shqyrtuar rekomandimin që ka ardhur nga Sekretariati për nominimet për këshillat e vendvotimeve apo siç njihet nga opinioni publik lidhur me kryesuesit dhe komisionarët në vendvotime dhe po ashtu edhe anëtarët rezervë të cilët do të jenë në ditën e zgjedhjeve për zgjedhjet lokale të 17 tetorit , ne e kemi analizuar veç e veç dhe e kemi shqyrtuar veç e veç secilën komunë duke respektuar formulën e miratuar më parë në KQZ lidhur me shpërndarjen e kryesuesve dhe anëtarëve te subjektet politike të cilat janë certifikuar për të marrë pjesë në këto zgjedhje dhe gjitha komunat janë miratuar në mënyrë unanime pra me 5 vota dhe janë shqyrtuar veç e veç janë analizuar që të mos përjashtohet asnjë subjekt politik që garon në ato komuna dhe kandidatët që garojnë në mënyrë të pavarur prandaj mendojmë si KOZ që ky rekomandim plotëson të gjitha kriteret dhe kërkesat që dalin nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme lidhur me nominimet dhe po ashtu është konform formulën të cilën e kemi miratuar më parë në KQZ prandaj rekomandoj që të miratohet në tërësi..Nwse ka dikush ndonjë koment lidhur me komunat përkatëse, jemi të hapur për diskutim...

Rifat Krasniq: Faleminderit kryesues, ne dje e kemi pas Këshillin për Operacione Zgjedhore, dhe qysh e kemi marrë vendim, se ndoshta kanë bërë gabim teknik për anëtarët e KVV, anëtarët kanë qenë 5, e dje ne e kemi marrë vendim me qenë 3...Nga një anëtarë me ia dhënë dy subjekteve tjera (edhe Erdemit edhe Iliaz Bajraktarit...

Arianit Elshani: Po vërtetë, sa i përket Komunës së Mamushës kemi pasur një diskutim dhe një debat më të gjerë dhe secili, ka shprehur qëndrimet e tij lidhur me shpërndarjen e këtyre vendeve që ju takojnë subjekteve politike qe duhet tu shpërndahen që jemi të obliguar dhe ne e dimë që me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme rregullohet që të jenë minimalisht 5 anëtar në këshillat e vendvotimeve e prandaj është brenda kësaj kërkesë ligjore, ne paraprakisht na ka determinuar formula e shpërndarjes na ka determinuar pastaj, këtë përbërje që e kemi këtu. Ka qenë edhe kërkesë e djeshme e z. Krasniq lidhur me PATP –në mirëpo, për shkak të ligjit dhe miratimit të mëparshëm edhe të formulës, nuk mund ti ikim... Në komunën e Mamushës ka ndryshime, pra pas diskutimeve të djeshme një anëtar që iu është shtuar Lëvizjes Vetëvendosje si kryesues në Mamushë dhe në anën tjetër, anëtarët të cilët janë transferuar te KKZ-ja për

të pasur një përfaqësim të barabartë të këtyre subjekteve tjera jo parlamentare, rekomandimi i KOZ-së është që të miratohet kështu si tërësi...

Burim Ahmetaj: Të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga mbledhja e fundit e Këshillit për Operacione Zgjedhore –Departamenti i Koordinim në Terren, i ka shpërndarë menjëherë në komisionet komunale të zgjedhjeve , KOZ ka dhënë 7 vërejtje për 7 komuna lidhur me listat dhe përbërjet që kanë paraqitur, Komuna e Mamushës respektivisht për përbërjen e këshillave të vendotimeve janë inkorporuar rekomandimet dhe vërejtjet siç janë dhënë në fund është vendosur që dy subjektet e para politike që kanë fituar vota më së shumti në parlamentin e Kosovës nga komuna e Mamushës ti kenë në përfaqësim kryesuesit e vendotimeve dhe anëtarët sipas asaj që e tha kryesuesi i KOZ-it dhe rezervat ti mbesin jo subjekteve politike të reja. Mirëpo, KKZ-ve sipas vërejtjeve që janë i kemi edhe në procesverbalet ashtu është edhe para jush do të thotë të gjitha këto që janë vërejtët në Komunën e Fushë Kosovës, në Komunën e Prishtinës, në komunën e Leosaviqit , Zubin Potokut edhe komunat tjera që janë më radhë edhe që në total sot janë paraqitur para jush 14.837 anëtarë të këshillave të vendotimeve prej tyre 2477 janë kryesues 10.689 anëtarë e që për Komunën e Mamushës është rekomandimi sipas vërejtjes së KOZ-it

Rifat Krasniq: Ne, dje që e kemi pas këshillin kryesues, u morëm vesh, u pajtuam edhe e kemi votuar: prej 5 anëtarëve, këtu me e nda nga një Erdemit dhe Bajraktarit sepse, Erdemi me i pas 3, dhe Ilaz Bajraktari 3. Ne, ashtu u pajtuam dje, ashtu e votuam...

Arianit Elshani: Pavarësisht s'i është votuar, a kemi të drejtë...?

Burim Ahmetaj: Jo, sepse kompozicioni i Këshillit të vendotimit me komunën e Mamushës në secilin vendvotim është 5 anëtarë dhe nuk mund të mbulohet një subjekt i ri politik me më shumë apo më pak, d.m.th., ndarja është në mënyrë proporcionale dhe si subjekte të reja politike i kanë vetëm vendet plotësuese sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe, edhe me rregullën 19/2016...

Kreshnik Radoniqi: Mirë e qartë është, a ka dikush diçka tjetër lidhur me këtë ?

Fazli Stollaj: Shkurtimisht...! Mendoj se nominimi i këshillave të vendotimeve është me rëndësi, i kemi shqyrtuar për një proces të mirë, mendoj se edhe në këshilla, kemi bërë përpjekje që të kemi gjithë përfshirje...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka, e hedh në votim: nominimin e këshillave të vendotimeve...Edhe Alimi, po supozoj që është për...! Atëherë, me vota unanime konstatoj se miratohen

Këshillat e Vendvotimeve (kryesuesit, anëtarët dhe anëtarët rezervë) për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021.

5.Shqyrtimi i Rekomandimit të Sekretariati, lidhur me aktivitetet e prokurimit:

Arianit Elshani: Kërkoj që të informohemi, se di, ndoshta tek të ndryshme lidhur me ekipet mobile se, kur planifikoni të na i dorëzoni, pra të na rekomandoni në Këshillin për Operacione Zgjedhore lidhur me afatet e ekipeve mobile..!

Burim Ahmetaj: Më lejoni të ju njoftoj që për këtë proces zgjedhor për organizimin e zgjedhjeve lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, Sekretariati i KQZ-së i ka zhvilluar të gjitha aktivitetet e prokurimit përmes procedurës së hapur, duke ofruar mundësi të barabarta gjithë operatorëve ekonomikë për të konkurruar përmes specifikave të cilat i ka përgatitur Sekretariati i KQZ-së për aktivitete të prokurimit që kanë të bëjnë me materiale zgjedhore që do të përdoren në ditën e zgjedhjeve. Nga gjithë ky proces, deri më tani pas përfundimit të të gjitha proceseve të vlerësimit nga Sekretariati, tri prej tyre kanë përfunduar me ankesë nga organet shqyrtuese të prokurimit: është fjala për shtypjen e doracakëve për procedurat e numërimit dhe votimit për zgjedhjet lokale 2021; është aktiviteti tjetër i prokurimit: shtypja e formave zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021 dhe furnizim me material për mbrojtje anticovid për stafin zgjedhor për zgjedhjet lokale 2021. Pra, të gjitha këto aktivitete kanë përfunduar procedurat e vlerësimit nga Sekretariati dhe është afati ligjor i ankesave.

Para se të nënshkruhet kontrata me operatorin e rekomanduar nga Komisioni vlerësues për lidhjen e kontratës, e dimë që organi shqyrtues i prokurimit nuk është funksional, e përveç kësaj, organi shqyrtues i prokurimit te aktiviteti me tabelën nr.1: “Shtypja e doracakëve” ka dhënë edhe mendimin e ekspertit ku i jep të drejtë KQZ-së se vlerësimi është bërë real edhe mund të vazhdojmë. Mirëpo, ky vlerësim i ekspertit nuk është i plotfuqishëm pa vendimin e organit shqyrtues të prokurimit. I kemi edhe dy aktivitete të tjera të prokurimit që kanë të bëjë me furnizim me Uvej sprej dhe Bexhat për të gjithë trupat zgjedhorë dhe për vëzhguesit. Pra, edhe këto dy aktivitete nuk kanë mundur të zhvillohen dhe tani jemi në fazën e ri tenderimit; Për shkak të urgjencës ekstreme do të vazhdojmë me zhvillimin e procedurave të negociuara të këtyre aktiviteteve që do të thotë se operatorin që është më i përgjegjshëm, do ta ftojme në negociim dhe me të do të lidhim kontratë...

Ligji i prokurimit, tha z. Ahmetaj, na e mundëson që përmes kësaj forme përmes urgjencës ekstreme të na japë të drejtë që të zhvillohet procedura me negociim mirëpo, i kemi tri aktivitete të prokurimit

(doracakët, format zgjedhore dhe materialet anticovid) të cilat, kanë përfunduar me ankesë në OSHP, dhe tash jemi në një fazën ku OSHP-ja nuk është funksionale. Nuk kemi ndonjë përgjigje zyrtare se si me vepruar, dhe Sekretariati ka mbetur i bllokuar për shkak të mos efikasitetit të OSHP-së...Kemi shkëmbyer letra edhe me OSHP-në, dhe me KRPP, mirëpo në një imell që e kanë dërguar më herët, e kemi edhe përgjigjen nga KRPP-ja por ajo është shumë e përgjithshme që nuk na udhëzon qartë se si të veprojmë përveç ku i referohet rasteve emergjente ekstreme që i jep secilit autoritet kontraktues që të lidhë kontratë me operatorë për shkak të rasteve emergjente. Tash në rastin tonë, e kemi rastin emergjent ekstrem sepse i kemi më pak se 16 ditë deri në ditën e zgjedhjeve dhe këto aktivitete, janë jetike për tu përdorë në ditën e zgjedhjeve...

Sami Kurteshi: Unë, kam bërë përpjekje të paktën me e përcjell këtë çështje, pajtohem me rekomandimin pjesërisht se, kam edhe një rekomandim që unë mendoj se çështja e parë është se secili operator ekonomik është, pa marrë parasysh veprimet ata që janë ankuar...Të drejtën e ankesës nuk mund tua pezullojë sipas ligjit askush, ata kanë të drejtë për me u ankuar. E dyta, ne kemi fazë, rast të emergjencës ajo është shpjeguar d.m.th., me rregullat e udhëzuesit operativ për prokurim publik, rregulla 115 pikat i kemi aty...Është e qartë se KQZ nuk ka mundur me i paraparë këto arsye, megjithatë unë mendoj se letra e KRPP-së është e qartë, nenin 35 paragrafi 2 i pikës 3 thotë se në këto raste, mund të veprohet natyrisht duke i dhënë të drejtën operatorit ekonomik ankues që sipas nenit 112 të ankohet... Unë pajtohem me rekomandimin e Sekretariatit por, unë jam për atë që për këtë çështje auditori i brendshëm ta marrë edhe ta auditojë këtë procedurë si ka ardhur deri te kjo, në njërën anë, është OSHP që nuk është në kompetenca tonat...; Aty ka punë kuvendi a kush e zgjedh...Por ne si autoritet kontraktues, duhet ta nënshkruajmë kontratën, duhet ta kryejmë punën tonë më 17 tetor, duhet të jenë të gjitha materialet të gatshme pa marrë parasysh ankesat në këtë fazë...Jam për ta diskutuar por, nuk jam për ta ndalur këtë veprim dhe të ndiqen gjithë hapat ligjor; Megjithatë, jam që një nga rekomandimet të jetë që auditori i brendshëm ta rishikojë këtë procedurë se s'i ka shkuar...

Ilir Gashi: Realisht, jemi në këtë gjendje. Këtu, nga të gjithat përshkrimet që ka bërë sekretariati po del të jetë pasojë e mos kompletimit të institucioneve të shtetit në disa nivele sepse, sikur OSHP të ishte e kompletuar nuk besoj se kishim ardhur te ky rekomandim për faktin se, mendimet dhe vendimet e saj ishin marrë shpejtë edhe ishin zënë afatet për me vepruar tutje. Eksperti, e ka dhënë një mendim të tij dhe në bazë të disa konsultave (personalisht, jam interesuar me pyet dhe ishin disa praktika që në raste të tilla kur organi është inekzistent, nuk është i kompletuar atëherë institucionet kanë të drejtë me marrë mendimin e ekspertit ose me e anuluar procesin). Unë, jam jem me e mbështetur secilin rekomandim të

mundshëm brenda të gjitha fazave ligjore dhe, mendoj që vendimi jonë ose mbështetja jonë duhet të jetë uniforme...

Ibrahim Selmanaj: Jemi para aktit të kryer ! Tash, në situatën ku jemi, këto probleme janë në nivel vendi nuk janë vetëm te KQZ por, ne jemi në situatë kur ditët janë të numëruara dhe si rrjedhojë, besoj duhet të japim një zgjidhje dhe të mbështesim këto rekomandime edhe t'i përmirësojmë rekomandimet në qoftë se ka hapësirë edhe juridike ose forma të tjera...Sido që të jetë, mendoj se duhet t'ia bëjmë një zgjidhje kësaj situatë...

Alim Rama: E mbështes çfarë kanë thënë parafolësit, mendoj se duhet me qenë dy elemente: një element i parë, ne gjithsesi duhet ta bëjmë një zgjidhje; këto materiale të prokurohen sepse, nuk mundemi me prit 17 tetorin pa këto materiale; Çfarëdo që ka ndodhë, ndoshta Sekretariati ka vepruar mirë dhe gjithçka është në rregull, megjithatë neve na duhet një konstatim i të gjitha procedurave deri ku kemi ardhur dhe pastaj të auditohen...Por të gjitha këto, asesi nuk duhen me e penguar procesin...

Florian Dushi: Është keq që kemi ardhur praktikisht në këtë situatë e cila, ashtu siç u tha nga kolegët drejtpërdrejtë rrezikon edhe organizimin dhe përmbajtjen e zgjedhjeve mbi bazën e asaj çfarë kemi dëgjuar këto ditë! E kemi diskutuar më shumë se njëherë këtë çështje edhe nëpër këshilla, në këshillin për buxhet dhe për operacione zgjedhore, kemi marrë shkresa, raporte dhe informata të ndryshme nga ana e segmenteve të caktuara të organizimit të këtyre proceseve brenda sekretariatit tonë; Dhe kemi ardhë në disa përfundime: e drejta e operatorëve për të bërë ankesa është e drejtë e garantuar me ligj prandaj, ne nuk mund të gjujkojmë askënd pse ka bërë ankesë në anën tjetër, mbi bazën e asaj që jemi informuar pavarësisht ndonjë tendence për të hedhë fajin, jemi njoftuar që prokurimi ka zhvilluar brenda afateve të parapara me ligj të gjitha këto procedura. Faji mund të konsiderohet jetim në situata të tilla por megjithatë sikur të kishte ekzistuar organi që është kompetent me ligj për të trajtuar këto ankesa, unë mendoj që ne nuk do të vinim në këtë situatë sepse ka rreth një javë që ne jemi njoftuar se jemi bllokuar në këtë proces...Unë besoj se ky organ ose ekzistenca e tij, do të bënte që këto ankesa ti trajtonte edhe ti vendoste me kohë dhe ne do të zhvillonim tutje. Tash në disa procedura të prokurimit, jemi në një pozicion shumë të pavolitshëm, prandaj unë natyrisht që jam për zgjidhje sa i përket kësaj por, nuk do të mbështes asnjë rekomandim i cili nuk ka bazë të qartë ligjore pavarësisht ndjeshmërisë së situatës në të cilën gjendemi sepse nesër asnjë organ ndjekës nuk do ta kuptojë ose nuk do ti intereson ndjeshmëria e situatës në të cilën jemi por thjeshtë të shohin nëse ne kemi vepruar ose jo në kundërshtim me ligjin prandaj, unë kërkoj qartësi prej sekretariatit, prokurimit dhe prej auditorit të brendshëm sa u përket rekomandimeve të cilët ata i ofrojnë për ne si KQZ, përndryshe unë do të qëndroj krejtësisht në një

pozicion: nuk do të marr pjesë me votën time dhe as me qëndrimin tim në mbështetje të këtyre rekomandimeve...

Nexhmi Haxhiu, zyra e Prokurimit: Deshta të ju njoftoj se, sipas procedurës, këto lëndë shqyrtohen në OSHP. Si do të veprohet më tutje ? Sipas ligjeve të prokurimit, në momentin që operatori ekonomik banë lëndën, pezullohet. Pajtohem me ato që tha z. Floriani, sepse lënda pezullohet: as nuk mundemi ta anulojmë, as nuk mundemi ta pezullojmë...Në këtë rast, në mungesë të OSHP-së paneli shqyrtues, do të thotë paneli ende si ka marrë lëndet me i shqyrtua, ndërsa një lëndë e ka marrë...Por eksperti shqyrtues, i propozon lëndën panelit shqyrtues por në këtë rast nuk ka organ shqyrtues, është i pa konstituuar që të merret ni vendim... Shtrohet pyetja, mbasi që nuk ka panel si do të veprohet me këto lëndë...? Ne, nuk mund të marrim përgjegjësi me anulue, ose me fillua, me lidh kontratë pa një vendim të panelit shqyrtues. Pyetja ime është: A mundet me marrë vendim KQZ me zhvillua procedurë, apo me lidhë kontratë me atë operator që e ka propozua eksperti shqyrtues, mbasi që nuk ka panel shqyrtues OSHP, apo me fillua me procedura të reja....? Në këtë rast, unë nuk kam përgjigje! Si prokurim, nuk kemi fuqi ligjore as me anulue dhe as me ritenderue pa një vendim qoftë të panelit, qoftë nga KQZ...

Kreshnik Radoniqi: Janë pesë procedura të prokurimit: Tri janë me ankesa. Çka janë dy të tjerat ?

Nexhmi Haxhiu: Dy janë në ri tenderim, dhe do të fillojmë të hënën me procedura të ri tenderimit me procedurë të ri negociuar...

Kreshnik Radoniqi, pasi që jemi në proces, të gjendet një zgjidhje...

Në diskutim dhe në shqyrtim të kësaj pike, në korniza të gjëra analizash dhe vlerësimesh u angazhuan: Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani, Burim Ahmetaj, Sami Kurteshi Alim Rama, Ilir Gashi dh Florian Dushi.

Po ashtu, auditori i brendshëm **Sylejman Gashi**, tha se rekomandimet që i kemi këtu janë të rregulluara më ligj; janë çështja e ofertave dhe dorëzimi të ankesave të rregulluara edhe për operatorët ekonomik! Por parashtrimi i ankesave, nuk duhet të parandalojë nënshkrimin e kontratës, sepse çështje është se nuk kemi institucione aktive dhe mundësi me ndikuar në të, por çfarëdo që të jete çështja e parë që po dua më ngrit para jush është se, kryetari i Komunitetit që unë i raporto, patë bisedë që me u marrë me këtë çështje dhe kjo çështje është primare që me u gjetur zgjidhja...Unë, kam qenë përcjellës pasivë i këtij procesi sepse, kame qasje në sistemin e prokurimit për çdo hap dhe veprim që bëhet në procedurat e prokurimit... Edhe unë e kame mendimin tim, vlerësimin tim se edhe një pjesë e madhe e kërkesave të mos them e të gjitha e ankesave, janë të pa bazuara sepse kam parë edhe në parashtrësën që kane bërë

për sqarime sepse, më vinë edhe mua në sistem dhe i shoh...Mirëpo, si do që të jetë, janë çështje që mbesin atje dhe deri sa nuk është funksionale, mbeten ashtu siç janë...

Unë tani po e them se është në kuadër të përgjegjësive të mija në kuadër të ligjit të kontrollit të brendshëm të financave publike, që ka të beje më dhënien e këshillave dhe rekomandimeve për zgjidhje dhe krejt kjo që unë tani po flasë është në kuadër të asaj që unë mund të japë këshilla dhe të rekomandoj atë që unë e vlerësoj se është në rregull në anën ligjore. Problemi është identifikuar gati tërësisht sepse janë dy probleme këtu: është një probleme me tri aktivitete që janë zhvilluar procedurat e rregullta në afate normale dhe cilat janë ankimuar në OSHP-ë dhe, dy aktivitete të tjera që janë zhvilluar më procedure të negociuara e pa publikime të njoftimit edhe të cilat, janë anuluar për shkak të mungesës së operatoreve të përgjegjshëm. Çështja e dytë është e lehte dhe, rregullohet me shpalljen e njoftimit të ri për prokurim me procedurat e reja ndërsa, për tri kontratat të tjera që janë unë e kam një mendim dhe tani po e jap: se për doracakët, është shumë afër koha edhe nuk e di a mund të prodhohen, edhe nëse lidhet kontrata. Ne, po lidhim kontratë, po marrim rrezik kështu që këtë çështje unë kërkoj që ta trajtojmë veçanërisht edhe përmes një vlerësimi të ri prej njësive kërkuese sepse, unë nuk mund të them po e bëjmë këtë veprim edhe pse ndoshta jo 100% është i ligjshëm dhe po e bëjmë një veprim tjetër edhe më të rendë sepse, nuk po mundemi me u sigurua e, ndoshta vetëm po shpenzojmë para në diçka që vetëm se ka kaluar. Kështu për doracakët unë e jap edhe këtu edhe me shkrim se mund të bëjë një rekomandim...

Mbetet që vlerësimin përfundimisht ta japë njësia kërkuese se bashku më gjithë njerëzit e tjerë. Çështja e formularit zgjedhor dhe çështja e materialit dezinfektues, janë edhe dy kontrata të tjera që janë shpallë fitues po që për shkak të proceseve anketuese, nuk mund të nënshkruhen... Por, ky problem të trajtohet edhe më tutje...

Arianit Elshani: Faleminderit shumë për rekomandime dhe për sqarime. Ashtu siç thatë, jemi në mes të dy rrugëve: njëra që të nënshkruajmë dhe njëra që të procedohen në procedura emergjente. Këtu, u fol dhe u rekomanduar një formë që të procedohen procedurat të reja dhe ato që janë aktuale të mbesin pra në OSHP-ë, dhe OSHP-ja të marr një venim mbi atë. Është i vërtet fakti se, mund të kemi sërish ankesë por, ne krijuam veçse një akordim që përpara të njoftohen të gjitha institucionet, të njoftohet Presidenca, Kuvendi, zyra e Kryeministrit lidhur më vendimin e KQZ-së dhe gjendjen ku jemi me këto tre inicime të procedurave që kemi pasur, dhe e dyta, të kërkohet nga organi shqyrtues i prokurimit ose nga KRPP-ja apo nga kushdo që të procedohet procedura emergjente për të iniciuar këto më kushtin që të hiqet masa pezulluese në rast të ankesës. Pra, ne nuk po heqim ankesën për palët mirëpo, po e heqim masën pezulluese... Pra, mendoj se është një rekomandim që ne ram dakord dhe për mua, meqenëse është

diskutuar tashme në tre mbledhje lidhur më rrezikun lidhur më rëndësinë e këtij vendimi dhe, të gjitha këto, unë vërtetë jam më shumë që të rrezikojmë në shumë më kuptime që ndoshta të kemi një transparence edhe më të madhe pro mendoj se iniciimi i procedurave të reja, mund të na krijoj neve një pasqyrë të qartë në qofte se vërtetë kemi bërë lëshim si KQZ-ë. Sa i përket doracakut, edhe unë pajtohem se nuk mund të realizohet brenda afateve kohore si aktivitet atëherë, ta shqyrtoni edhe një here më njësinë kërkesë....

Sylejman Gashi: Është kërkesë e imja atë që e ngriti Arianiti...! Proceset që kanë me u zhvillua më tutje të jenë të monitoruara dhe të jene të suksesshme. Unë po them që nuk është 100% ligjore por, në atë formën e krahasimit të rrezikut me atë që është qëllimi, unë po kërkoj që të zhvillohet procesi shumë transparent dhe të jetë i saktë, dhe se analizat se çfarë kemi bërë dhe çfarë kemi kërkuar të bëjmë të përputhen, të jenë të arsyetuara me prokurimin.

Iliri Gashi: Si institucion, a jemi ne brenda krejt afateve ligjore të zhvillimit të punës ?

Nexhmi Haxhiu: Ne këso raste, kemi pasur edhe herrave të tjera: ankesa në OSHP-ë, por me iniciativën e krye shefit ekzekutiv, ne kemi shkuar çdo herë dhe kemi kërkuar të OSHP-ja tu japë prioritet lëndëve të KQZ-së.

Čemailj Kurtiši: Shkurt, kemi variante të ndryshme...Mundemi me ba mirë, dhe keq ! Por zgjedhjet janë në prag, dhe ne nuk mundemi me i rrezikua zgjedhjet. Rrethanat janë këto që janë, por e, nuk mundemi me shuke qysh thotë ligji por, edhe zgjedhjet nuk mund ti rrezikojmë... E tash, mirë e zbërtheu dhe e sqaroi z. Gashi, dhe unë vlerësoj se jemi edhe në pandemi që, të dalim nga ky labirint dhe, të votojmë bashkarish me koncensus dhe të marrim një vendim...

Florian Dushi: Tani Faktikisht po mbetemi të dy variantet të këto raste që janë më ankese në OSHP-ë, ajo që ngriti më herët kolegu Rama dhe na është konfirmuar në një fare forme që po mund të zhvillohet edhe në atë forme duke injoruar në një far forme ankesat që janë dërguar atje dhe duke zhvilluar procedura krejtësisht të reja dhe forma tjetër është që në dy rastet të thirret operatori fitues dhe të nënshkruhet kontrata më ta, por megjithatë mendoj që ky rasti i dyte më që e kemi edhe një fare shenje që jemi krejtësisht në rregull është mendimi i ekspertit nuk e di a kemi ende vetëm për një apo kemi tani për dy. Megjithatë, tani OSHP-ja më ndihmën e ekspertit të vete aprovon shumicën e rasteve, prandaj unë mendoj që edhe mos më u ballafaquar më ato ankesat që mund të përsëriten serish edhe për shkakë që megjithatë njërën prej të dy rasteve kemi një mendim pozitive të ekspertit unë mendoj që ma mire do të ishte që të shkojmë dhe të thërrasim dy operatorët që ne e kemi shpallur fitues edhe për njërin te cilin e

kemi mendimin e ekspertit të OSHP-së edhe pse deri në vendimin final të OSHP-së ai është në një fare forme pa ndonjë vlerë juridike por të zgjidhet kjo forma sipas të cilës ne do të i thirrshim dy operatorët që kemi shpallur fitues edhe më nënshkruar kontratat më ta...

Alim Rama: Faleminderit, tani jemi të ajo dilema që kam ngrit në fillim, për mua pasi që procesi është vetëm i pezulluar unë jam i mendimit që më të njëjtin operator pasi që janë trajtuar procedurat që të thirren në një procedure të re sepse në këtë rastë në rastë të ankesës kjo procedura mbetet por i njëjti operator...Të rishikohen edhe një here procedurat për shkak të kohës tash a mundet diçka më thjeshtëzuar tani kemi puna çështja edhe kohës atëherë fillojnë dy procedura që sekretariati të rishqyrton dhe një here të gjitha këto pese procedura në qofte së ka hapësirë më thjeshtësuar tani më masa në fillime keni vendos për kohe të rregullt tani duhet më u përshtat për shkak kohës së shkurtuar që të fillojnë më ata të njëjtit operatorë edhe të fillojmë më procedura emergjente.

Kreshnik Radoniqi: Unë jam tu dashtë më e përmbledh qeto dhe më përfunduar po më doket ideja e injorimit të OSHP-së atje edhe më vazhduar më procedure më doket ke ma e pranueshme për krejt, ajo më mbet në pezullim edhe më vazhduar në më procedura emergjente edhe më i njoftuar institucionet tjera për këtë aktivitet tonin së unë për veti nuk e di as kush e ka fituar at procedure edhe gjithçka ndërlihet më dashjen për qatë kompani, po supozoj së as ju nuk e dini se kush e ka fituar idenë më të vogël nuk e kam; Kështu që ne jemi duke u marr më procedure qysh me zhvilluar të shpejt se kemi ngecur jo më dashtë dikujt më i bere favorizime për këtë arsye për mendim timin më hedh në votim ne që më zbatuar njërin prej rekomandimeve që keni propozuar, apo ndryshoje...

Nexhmi Haxhiu: Kryetar nëse më lejohet së është pak problematike nëse themi më shkuar ri tenderim d.m.th që duhet më filluar procedure të negociuar nëse themi më ja jep atyre që janë rekomanduar për kontrate këto janë dy çështje a më shkuar më ata që kemi jep rekomandim për njoftime për kontrate, mendimi jem është ky, kisha propozuar që më shkuar për ata propozime për kontrate dhe lënda jete pezullim nëse do të ketë vrenjtë apo shkelje ligjore atëherë shkojnë më ankesa, nëse shkojmë më procedura të reja duhet më i ftuar prape këta operator ekonomik më marr pjese në të ose vetëm më një.

Burim Ahmetaj: Po, ne të gjithë ketë punë jemi duke e bërë, duke u thirrur në situatën emergjente, e kemi dy versione para vetit e para është më lidh kontrate direkt më ata që ka fituar dhe është rekomanduar që ka fituar tenderin dhe e dyta është më shkuar më procedure të re duke u thirrur në këtë nevojën emergjente ekstreme që është baze më shumë ligjore dhe kushdo nesër mundemi më argumentuar së për shkakë të këtyre rrethanave është dashtë më zhvilluar procedurën prej fillimi duke

thirr fituesin unë mendoj që kjo është mënyra ma e mire që mundet më na argumentuar sepse nëse e thirrrem direkt fituesin pa zhvilluar procedurën po më doket e pa argumentuar ky është mendimi im .

Sylejman Gashi: Duhet me u përputh çështjet: nëse ne e kemi një kontratë të rregullt më afate të rregullta afatet e ankesave dhe afatet për vendosje të ato janë të rregullta dhe flasim për afate të rregullta çështjet më procedura të negociuara dhe këto më emergjence nuk mundemi më aplikuar për një procedure të rregullt që është zhvilluar kështu që zgjedhja e vetme është më u thirr operatori ekonomik fitues mu bo njoftimi për ata me u mbyll ajo procedure e rregullta e hapura sepse nuk mundem më përdor veprime procedurës emergjente për procedure të rregullt kështu që unë mendoj dhe jam shumë i sigurt.

Florian Dushi: Më u sqaruar këta dy operator që janë zhvilluar procedure të rregullt të hapur ne nuk po prekim asgjë në procedure procedura nuk po ndryshon në emergjente vetëm po e nënshkruajmë më ta në emër të emergjencës dhe procesi në OSHP-ë vazhdon..

Sylejman Gashi: Tash bohet fjale për mbyllje të një procedure të rregullt që nuk ki mundësi më shkuar më tutje dhe fillon një procedure e negociuar emergjente që zbaton masat dhe afatet që kërkon ajo emergjente prape unë po e thamë fituesi i shpallur më procedurën e rregullt më u thirr edhe më nënshkruar edhe më procedurën emergjente por që afatet brenda dite më i krye ose brenda dy dite mundesh më e krye këtë procedure më procedurën e më hershme nuk e lejon ato gjera.

Kreshnik Radoniqi : Unë për qeta jam i pa sigurte, se në këtë formë, ne jemi duke e favorizuar kompaninë e cila ka fituar...

Sami Kurteshi: Për mua kjo është çështja e keni operatorët fitues, të drejtën e ankesës me ligj e kanë, ata le të vazhdojnë me ankesa, e ne të vazhdojmë më punën tonë...Le të kryhet puna me operatorët fitues dhe ne, ashtu kështu kemi me pasur ankesa...

Nexhmi Haxhiu: Nëse më lejohet, plotësisht pajtohem me parafolësit: arsyeja është kjo se nëse ne shkojmë me procedurë të hapur, dhe shkojmë me procedurë të negociuar...Me e thirr të njëjtin operator ne s'po bëjmë asgjë këtu, se atë vetëm po e forcojmë që po ja jepmi atij. Lënda që është e pezulluar, le të merret vendim që ai operator fitues që është shpallur cili do që ka dhanë një mendim të ekspertit dhe ne që kemi dërguar për rekomandim me ta, lidhem kontratë në raste emergjente. Situata është si është, për këto raste kemi rekomanduar dhe këta, dhe nëse shkojmë prapë me procedurë me e thirr edhe atë tjetrin që ka fituar, pra me shkuar në procedurë të negociuar...

Kreshnik Radoniqi: A po pajtoheni me këtë rekomandim të gjithë, e që është më i miri i mundshëm në bazë të situatës që është krijuar dhe, në përputhje më ligjin që do të thotë, edhe jo krejt 100%...?

Sylejman Gashi: Kryetare procedurat e negociuara kështu sqarim behet në baze të historive të më pashme që e ki më njëjtën veprimtari më njëjtin operator të dëshmuar dhe më analiza kontratave në treg, kështu që ne e kemi një material, e kemi një lende, një operator ekonomik që është vlerësuar prej komisionit që është i përgjegjshëm dhe i plotëson kushtet kërkesat tona edhe u shpall më i miri dhe çfarë arsye ka mos më thirr ata në kushte dhe specifika të njëjta pa ndryshuar asnjë shkronje mos më thirr ata në kushte të emergjencës.

Kreshnik Radoniqi: Në rregull Sylë, ju e dini këto pune, urdhëro Ilir?

Ilir Gashi: Për shkak se ne tani edhe po diskutojmë, përgjegjësia jonë këtu është që me mundësuar shkuarjen në procedurë: këtu përfundon. Ne, as nuk rekomandojmë me shkuar me një, me dy, me tre, çka bon pastaj pjesa e prokurimit kjo është përgjegjësi e tyre, jo e jona...Ata e dinë zgjidhjen, nga ne po kërkohet vetëm shkuarja me procedurë emergjente. Kaq, këtu përfundon e jona. Kënd e thirrin, e çka bajnë pastaj, o problem i tyre...

Kreshnik Radoniqi: Pra, rekomandimi është me u zhvilluar një procedure emergjente për krejt procedurat e tenderimit, jo vetëm këtyre të djave por, edhe ato tjerat... Prokurim emergjent ekstrem; Në rregull me qenë se, e diskutuam gjatë dhe i kemi dilemat tona të gjithë por megjithatë, duhet me e marrë një vendim; U shkel nuk u shkel ligji, ne thjeshtë duhet me e njoftuar edhe parlamentin. Kush është për këtë rekomandim ? Që domethënë, me u zhvilluar një procedurë emergjente ekstreme për krejt rastet, për pesë procedura...?

Atëherë, kush është për...?

Më vota unanime rekomandohet ky propozim.

Kreshnik Radoniqi: Sekretariati, t'i zbatoj këto procedura shpejt, filloni sot nëse është e nevojshme! Edhe ato shkresa për mendim timin është mirë me ju drejtuar institucioneve tjera, e për me ju tregua atyre se për shkak të kësaj sate, është dashur me marrë një vendim që nuk është tërësisht në përputhje me ligjin...

6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik:

Fazli Stollaj: Këshilli për Mbikëqyrje të Informimit Publik ka shqyrtuar dhe miratuar video spotin për motivime të votimit. Këshilli mbikëqyrës, më 1 tetor ka shqyrtuar dhe miratuar tri video spote: video spotin për motivime për votim që i motivon të gjithë votuesit që të dalin në zgjedhje sa më në mënyrë masive më 17 tetor, video spotin për mënyrën e votimit të votueseve të infektuar më covid, dhe video spotin me mënyrën e votimit me masa mbrojtëse nga covid 19. Këto janë tri video spote që janë miratuar, gjithashtu këshilli ka miratuar edhe dizajnin e posterit që e ilustron mënyrën e votimit me masa mbrojtëse dhe, ka miratuar media planin për transmetime në televizione të këtyre video spoteve. Gjithashtu, publikime edhe të këtyre produkteve në rrjetet sociale dhe në portale...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit shumë. A ka dikush diçka tjetër, në të ndryshme...?

Arianit Elshani: Një njoftim e patëm prej sekretariatit lidhur me ekipet mobile.

Burim Ahmetaj: Ekipet mobile, janë deri më datën katër qysh është raportuar në fillim, kur edhe përfundon periudha e regjistrimit kështu që, ne jem në proces të këtij aktiviteti. Mendojmë që me datën katër do t'i kemi, shkresat i kemi dërguar. Ndërsa, sa u përket personave të ngujuar për shkak të covidit, dhe është afati dhe në bashkërendim me qendrat e emergjencës jemi duke i marrë të dhënat e personave të infektuar...Për ekipet mobile përfundon aktiviteti më 4 tetor...